

PËRSHKRIMI DHE SPECIFIKIMET PËR PROJEKTIN “FESTIVALI I DRITAVE”,
QË DO TË ORGANIZOHET NË DATAT 28-29 NËNTOR, NË KUADËR TË
FESTIMEVE TË 70-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË VENDIT

"Festivali i Dritave" i kushtohet përkujtimit të ngjarjes historike më thelbësore të shek. XX, e cila gjatë Luftës së Dytë Botërore e vendosi Shqipërinë dhe popullin shqiptar, në një radhë me të gjitha vendet e koalicionit ndërkombëtar antifashist që i shpalli luftë koalicionit fashisto-nazist është një projekt, qëllimi primar i të cilit është të ruhet e pastër memoria e kombit shqiptar, të tregohet realisht përpjekja dhe lufta e tij për Çlirimit e vendit dhe vullnetin e tij, për të qenë një vend i lirë evropian.

Kjo ngjarje do të përkujtohet në arsye historike dhe njohjeje drejtuar rinisë shqiptare, për tu informuar mbi angazhimin serioz të popullit shqiptar në këtë luftë dhe orientimin e tij në zhvillimet perëndimore. Organizimi i saj ballafaqon këtë pjesë të historisë së kombit shqiptar me historitë e kombeve të tjerë që u angazhuan në këtë luftë.

Ky projekt do të implementohet në 5 Godinat si më poshtë vijon:

1. Fasada e Universitetit të Tiranës (Politekniku)
2. Fasada e Universitetit të Arteve
3. Fasada e Kryeministrit
4. Fasada e Kuvendit
5. Fasada e Galerisë Kombëtare të Artit

Imazhet, foto dhe/ose video të ngjarjeve në këtë kuadër, do të jenë si më poshtë vijon:

Situata në botë (foto dhe/ose video):

7 Prill Pushtimi i Shqipërisë nga Italia Fashiste

Sulmi i Gjermanisë ndaj Polonisë në 1 shtator 1939, njihet edhe si fillimi i Luftës së dytë botërore.

Më 3 shtator 1939 Franca dhe Anglia i shpallin luftë Gjermanisë.

Në maj të 1940 u sulmua Belgjika dhe në qershor 1940 kapitullon Franca. Në korrik të vitit 1940 gjermania sulmon Britaninë. Në shtator të 1940 përfundon beteja e Londrës.

Në tetor të vitit 1940 Italia sulmon Greqinë dhe humbja e saj në Greqi.

Në vitin 1941 kemi masivizimin e luftës dhe shtrirjen e saj në Europën kontinentale.

Në prill të 1941 kemi pushtimin e Greqisë nga Gjermania naziste.

Fronti gjerman në Afrikën e Veriut. Operacioni Barbarosa.

Kampet e përqendrimit në Auzhvic, Mathauzen, Dakau etj.

Pushtimi i Sevastopolit dhe sulmi drejt Moskës.

Në dhjetor të 1941 militaria japoneze sulmon bazën Amerikane në paqësor , “Pearl Harbour”.

Fronti i Afrikës Veriore (Libi-Egjpt).

Fillimi i betejës së Stalingradit në shtator 1942.

8 shtator 1943 kapitullimi i Italisë fashiste dhe zbarkimi i Aleatëve në Siçili.

Në qershor 1944, zbarkimi në Normandi.

Masivizimi i luftës në Shqipëri (foto dhe/ose video):

Krijimi i çetave partizane dhe krijimi i njësive më të mëdha luftarake, të cilat ruajnë atmosferën e kohës dhe janë shumë interesante për të krijuar një mjedisin e ngjyrave gri të asaj periudhe.

Konferenca nacional-çlirimtare e Pezës, me parullën “bashkim pa dallim feje, krahine dhe bindje politike”

Marrëdhëniet e Aleatëve me forcat politike dhe në mbështetje të luftës së popullit shqiptar.

Zbarkimi i aleatëve anglezë në Spille.(Material origjinal i filmuar dhe i daktilogruar, dhuruar MHK, nga Bejtullah Destani)..

Mbledhja e Mukjes.

Kapitullimi i Italisë Fashiste dhe Pushtimi gjerman, Barmashi, Borova...

Batalioni “Antonio Gramshi”

Operacioni i Dimrit 1943 – 1944 dhe ai i pranverës.

Terrori dhe Masakra e 4 shkurtit në Tiranë.

Kalimi në mësymjen e përgjithshme të UNÇ.

Pjesëmarrja masive e të rinjve e grave në Luftën Antifashiste.

Çlirimi i Tiranës dhe krejt Shqipërisë.

Lufta përtej kufijve për çlirimin e popujve të Jugosllavisë.

Qëndrimi i Aleatëve gjatë Luftës Antifashiste Nac.Çl.

Hebrenjtë në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Duke qenë se godina e Korpusit të Universitetit ka shërbyer si godinë e Komandës së Forcave të Armatosura Italiane në Ballkan, prej andej do të fillojë edhe projekcioni i rezistencës shqiptare në 7 Prill dhe të përfundojë me pamjet nga çlirimi i Tiranës dhe Shqipërisë në fasadën e Galerisë Kombëtare të Arteve.

“Festivali i Dritave do të shoqërohet me tinguj të cilët sinkronizohen me lëvizjet e dritave, imazheve dhe efekteve sonore. Hera herës do të përdoren edhe projekte video që sjellin një dimension vizual. Do të përzgjidhen këngë apo copëza muzikore, shqiptare, po edhe internacionale që evokojnë luftën e fitimtareve, gjithashtu projekti do të shoqërohet me tekste që sjellin historinë e godinës ku projektohet.

Gjithashtu për të realizuar imazhet që do të projektohen, do të përdoren duke u përzgjedhur një set veprash arti, piktura, vizatime dhe skulptura, si më poshtë vijon:

1. "Epika e Yjeve të Mëngjesit" e Edison Gjergos,
2. "Kalimi i Divizionit të Parë", pikturë e Sadik Kacelit,
3. "Në pritë" dhe piktura "Duke pritur ditën e Çlirimit" të Nexhmedin Zajmit, pikturën "Çlirimi i Tiranës" të Bukurosh Sejdinit,
4. Piktura "Skroskë 1944" të Fatmir Haxhiut,
5. Pjesa e Luftës të triptikut vertikal që ndodhet në fasadën e Kryeministrisë, me disa autorë,
6. Portretin "Qemal Stafa" të Janaq Pacos
7. "Vojo Kushi" të Odise Paskalit.

FONDI TOTAL

28.000.000 LEKË ME TVSH

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR SECILËN GODINË:

Universiteti politeknik

- 2 video projektorë 20,000 Ansi
- 2 video projektorë 35,000 Ansi
- 1 media server
- 1 realizim grafik
- 1 foni 35,000 watt line array
- 1 regji fonie
- 6 ndriçues led rgb 800 watt secili
- 24 robotë beam me llambë 5r
- 1 pult ndriçimi me 4 universe
- 1 dalje korrenti 220 volt 3 fazor me 63 amper ne faze
- 4 kulla skeleria për vendosjen e projektorëve 4 m lartësi

Akademia e arteve

- 3 video projektorë 20,000 ansi
- 1 media server
- 1 realizim grafik
- 3 kulla skelerie për vendosjen projektorëve 4 m lartësi
- 1 dalje korrenti 220 volt 3 fazor 32 amper ne faze

Kryeministria

- 2 video projektorë 20,000 ansi
- 1 media server
- 1 realizim grafik
- 1 foni 15,000 watt
- 1 regji fonie
- 1 dalje korrenti 220 volt 3 fazor 32 amper ne faze

Kuvendi

- 3 video projektorë 15,000 ansi
- 1 video projektor 20,000 ansi
- 1 media server
- 1 realizim grafik
- 1 dalje korrenti 220 volt 3 fazor 32 amper ne faze

Galeria e arteve

- 4 video projektorë 15,000 ansi
- 1 media server
- 1 realizim grafik
- 1 foni 10,000 watt
- 1 regji fonie
- 4 kulla skelerie për vendosjen e projektorëve 4 m lartësi
- 1 dalje korrenti 220 volt 3 fazor 32 amper ne faze

DOKUMENTACIONI TEKNIK DHE LIGJOR I OPERATORËVE EKONOMIKË

I. Operatori ekonomik/bashkimi i operatoreve ekonomik që do të marrë/marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes së ofertave nga operatorët e specializuar për “*Festivalin e Dritave*” përmban :

- ✓ Ekstrakt të QKR
- ✓ Vërtetim për pagimin e tatim taksave.
- ✓ Vërtetim që nuk është në ndjekje penale (QKR)
- ✓ Vërtetim që operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (QKR)
- ✓ Kontrata për aktivitete artistiko kulturore të përmasave të ngjashme sipas specifikimeve teknike të kërkuara për tre vitet e fundit.
- ✓ Të ketë/kenë jo më pak se 12 punëtorë të siguruar
- ✓ Kopje të noterizuar të bilancit për tre vitet e fundit të shoqëruara me vërtetim për xhiron vjetore.
- ✓ Dokumentacion ligjor që vërteton se subjekti i ka siguruar pajisjet për realizimin e projektit sipas specifikimeve të kërkuara.
- ✓ Sigurimin e ofertës në masën 3% të vlerës totale të fondit limit në formën e garancisë bankare apo në agjenci sigurimesh. Sigurimi i ofertës do të ngurtësohet për 30 ditë nga dita e paraqitjes së ofertës në emër të Ministrisë së Kulturës. Sigurimi i ofertës do të mbahet nga Ministria e Kulturës në rast se operatori i shpallur fitues do të tërhiqet nga nënshkrimi i kontratës.
- ✓ Vërtetim nga OSSHE janë paguar detyrimet e energjise elektrike të muajit të fundit përpara shpalljes.

II. Operatori që merr pjesë në konkurrim përveç dokumentacionit të përgjithshëm duhet të paraqesë:

- ✓ Përshkrim i kompanisë dhe CV e saj ku të specifikohet eventet që ka realizuar.

Mungesa qoftë dhe e njërit të dokumentacionit të kërkuar në pikat I dhe II përbën kusht skualifikues.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomike, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së ciles bashkimi i operatoreve ekonomike është krijuar zyrtarisht ku të përcaktohen detyrimet dhe angazhimet e secilit;
- b. Prokura e posacme.

Shënim: Dokumentacioni ligjor duhet të origjinal apo fotokopje të noterizuar të lëshuar jo më vonë se tre muaj nga data e përcaktuar për hapjen e ofertave. Sigurimi i ofertës të jete origjinal.